

## **PJESA E PARË E MATERIALIT**

### **HYRJE**

#### **I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA**

1. Mikroekonomia studion:

- a) Firmat e biznesit;
- b) Tregjet e veçanta;
- c) Ekonominë e një shteti;
- d) a dhe b.

2. Makroekonomia studion:

- a) Korporatat multinacionale;
- b) Segmente të veçanta të ekonomisë;
- c) Ekonominë kombëtare;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

3. Sipas drejtimit klasikë:

- a) Ekonomia kombëtare ka aftësi vetërregullimi;
- b) Disekuilibret janë të periudhave afatshkurta;
- c) Nevojitet intervenim i shtetit;
- d) a dhe b.

4. Sipas drejtimit Kejnsonian:

- a) Papunësia në shtetet kapitaliste është e përkohshme;
- b) Papunësia e detyruar është e mundshme dhe në periudhat e gjata kohore;
- c) Për rritjen e kërkesës agregate nevojitet intervenim i shtetit;
- d) b dhe c.

5. Depresioni I thellë ekonomik (1929 – 33) rezultoi me:

- a) Zvogëlimin e PBB, konsumit dhe rritjen e industrisë;

- b) Zvogëlimin e punësimit, rënien e industrisë dhe rritjen e kursimit;
- c) Tkurrijen e PBB, konsumit, punësimit dhe industrisë;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

## II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA (G – gabim, S – saktë)

1. ----- Ekonomia klasike lidhet me emrin e ekonomistit të famshëm anglez Adam Smith.
2. ----- Xhon Majnard Kejnsi llogaritet si themelues i makroekonomisë.
3. ----- Drejtimi Kejnsian dominoi në periudhën 1945-1974.
4. ----- Në kohën e Kejnsit inflacioni ishte problem serioz ekonomik.
5. ----- Në depresionin e madh ekonomikë me përjashtim të Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, të gjitha shtetet e rruzullit tokësor përjetuan norma negative zhvillimore.
6. ----- Ekonomistët vlerësojnë se një ekonomi e cila realizon norma vjetore rritjeje të ekonomisë prej 5%, PBB e saj do të dyfishohet për 14 vite dhe ekonomitë të cilat realizojnë rritje të ekonomisë prej vetëm 1%, PBB e tyre do të dyfishohet për 70 vite.
7. ----- Japonia në periudhë të gjatë kohore (1953-1973) realizoi norma vjetore të rritjes ekonomike prej 3%.

## III. PËRGJIGJU PYETJEVE TË MËPOSHTME

1. Numëro 4 objektivat e makroekonomisë:

---

---

---

---

2. Rivendos 3 instrumente me të cilat arrihen objektivat makroekonomike:

---

---

---

3. Numëro 3 supozimet kryesore të drejtimit ekonomik neoklasik:

---

---

---

#### **4. PYETJE PËR PËRSËRITJE**

1. Përse duhet ta mësojmë makroekonominë?
2. Si rregulloheshin ekuilibrat ekonomikë sipas drejtimit klasik? Si vepronte dora e fshehtë në rrjedhat ekonomike?
3. Cili ekonomist llogaritet si themelues i makroekonomisë? Çfarë kthese revolucionare bëri ai në ekonominë bashkëkohore?
4. Çfarë masash ekonomike propozon Kejnsi për tejkalimin e depresionit të thellë ekonomik të viteve 1933 -39? Përse drejtimi kejnsonian përjetoi krizë gjatë viteve 1974 -75 dhe 1980 – 82?
5. Çkuptoni me drejtimin ekonomi Neokejnsonian dhe Neoklasik?
6. Cilat janë objektivat e makroekonomisë dhe instrumentet për realizimin e tyre?
7. Ç'kuptoni me politikat monetare dhe fiskale? Kur zbatohen politikat monetare dhe fiskale restriktive dhe ekspansioniste?
8. Ç'kuptoni me politikat ekonomike ortodokse dhe heterodokse? Në cilat raste përdoret e para dhe në cilat raste e dyta?

## **KËRKESA AGREGATE (AD) DHE OFERTA AGREGATE (AS)**

### **I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA**

1. Kurba e kërkesës agregate ka pjerrtësi:
  - a) Rritëse;
  - b) Është horizontale;
  - c) Pjerrtësi rënëse;
  - d) Është vertikale.
  
2. Kurba e ofertës agregate në periudhë afatshkurtër ka:
  - a) Pozitë horizontale;
  - b) Pjertësi zbritëse;
  - c) Pjertësi rritëse;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
3. Me ofertë agregate të pandryshuar dhe me një rritje të kërkesës, çmimi ekuilibër:
  - a) Do të zvogëlohet;
  - b) Do të rritet;
  - c) Nuk ndryshon;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
4. Me kërkesë agregate të pandryshuar dhe me një rritje të ofertës, çmimi ekuilibër:
  - a) Do të rritet;
  - b) Do të zvogëlohet;

- c) Nuk ndryshon;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
5. Sipas klasikëve kurba e ofertës në periudhë afatgjatë kohore ka pozitë:
- a) Horizontale;
  - b) Pjerrtësi zbritëse;
  - c) Pjerrtësi rritëse;
  - d) Vertikale.
6. Kurba e ofertës në periudhë afatgjatë kohore tregon se PBB aktual nga ai potencial është:
- a) Më i madh;
  - b) Më i vogël;
  - c) Janë të barabartë mes veti;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

## II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA (G – gabim, S – saktë)

1. ----- Rritja e kërkesës agregate , tkurr ekonominë kombëtare, dhe anashjelltas.
2. ----- Sipas klasikëve shteti nuk duhet të rri duarkryq në periudhat e tkurrjes së kërkesës agregate, por duhet të ndërmarr masa konkrete.
3. ----- Vendimet e amvisërive për të rrit konsumin dhe vendimet e bizneseve për të rrit investimet zgjerojnë kërkesën agregate.
4. ----- Niveli i lartë teknologjik, kualifikimi i lartë i fuqisë punëtore dhe kostot e ulëta për njësi prodhimi, ulin ofertën agregate.
5. ----- Ekonomia në periudhë të gjatë kohore punon në nivelin e potencialit prodhues me shfrytëzim maksimal të resurseve dhe nivelin e punëzënies së plotë.
6. ----- Ekonomia e Britanisë së Madhe gjatë depresionit të madh ekonomik 1929 – 33, Luftës së I Botërore 1914 – 18 dhe Luftës së II Botërore 1939 – 45 shënoi rënie të kërkesës agregate e cila tkurri ekonominë kombëtare.

7. ----- Në konominë e Britanisë së Madhe në vitet 1978 -1981 çmimet e naftës u dyfishuan dhe ekonomia stagnoi (stagflacion).
8. ----- Sasitë e rritura të prodhimit të naftës nga vendet e OPEC-ut në vitin 1986 rezultuan me rritjen e ofertave agregate.

### III. PËRGJIGJU PYETJEVE TË MËPOSHTME

1. Trego 4 faktorë të cilët determinojnë kërkesën agregate:

---

---

---

---

2. Trego 4 faktorë të cilët determinojnë ofertën agregate:

---

---

---

### IV. PYETJE PËR PËRSËRITJE

1. Ç'kuptoni me kërkesën agregate?
2. Ç'kuptoni me ofertën agregate?
3. Ku është dallimi midis Klasikëve dhe Kejnsianëve, sa i përket ekuilibrave makroekonomik dhe papunësisë?
4. Shiko grafikët 4, 5, 6 dhe 7 në këtë kapitull dhe shpjego rëndësinë e kërkesës agregate sipas Kejnsit. Shpjego pse kurba e ofertës agregate në periudhë afatshkurtër ka pjerrtësi rritëse e cila në fillim është më e sheshtë dhe sa vjen bëhet më e pjerrët. Pse kurba e

ofertës agregate në periudha afatgjata merr formën vertikale? Shpjego ofertën sipas modeli klasik.

5. Çfarë masash ekonomike duhet të zbatohet për të nxjerr ekonominë nga kriza sipas Kejnshit?
6. Çkuptoni me kurthin e likuiditetit?
7. Çfarë efekti kishte goditja e kërkesës në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar në krizën e madhe botërore 1929 – 33, Në Luftën e I dhe II Botërore?
8. Çfarë efekti ekonomik kishte goditja e ofertës nga shtetet eksportuese të naftës (OPEC) në vitet 1972 -75? Çfarë efekti kishin thatësit e vitit 2011? Cilat ishin efektet e zvogëlimit të ofertës së naftës në vitet 1973 – 75 dhe 1978 – 81 në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar?
9. Shiko grafikun 9, 10, 11 dhe 12 të këtij kapitulli dhe shpjego ekuilibrin makroekonomi në periudhat afatgjata dhe afatshkurta kohore dhe disekuilibrat të shkaktuara nga ana e kërkesës dhe ofertës agregate.

**MATJA E AKTIVITETIT EKONOMIK****I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA**

1. PBB prezanton të mirat dhe shërbimet e përgjithshme:
  - a) Të veprimtarive legale dhe jo legale;
  - b) Finale dhe atyre të ndërmjetme;
  - c) Finale të prodhuar për një vit të shprehura me çmimet e tregut;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
2. PBB nominal matet me:
  - a) Çmimet e një viti bazë;
  - b) Çmimet vijuese ose korente;
  - c) a dhe b;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
3. PBB real matet me:
  - a) Çmimet vijuese;
  - b) Çmimet e një viti bazë;
  - c) a dhe b;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
4. Sektorët konsumues të cilët ndikojnë në PBB janë:
  - a) Familjet;
  - b) Bizneset;
  - c) Qeveria;
  - d) Këmbimi i jashtëm;



- e) Të gjitha së bashku.
5. Papunësia ciklike është pasojë e:
- a) Kërkesës për vende të reja më të mira të punës;
  - b) Mos përputhjes së ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore;
  - c) Lëvizjeve ciklike të ekonomisë;
  - d) a dhe b.
6. Prodhimi Kombëtar Bruto (GNP), prezanton të mirat dhe shërbimet:
- a) Të prodhuara Brenda disa viteve;
  - b) Të prodhuar brenda vitit;
  - c) Të prodhuara brenda vitit plus pagesat neto faktoriale nga jashtë;
  - d) Asnjërën nga të mësipërmet.
7. PBB potencial shpreh tendencat e rritjes ekonomike në periudhën:
- a) Afatshkurtër;
  - b) Afatmesme;
  - c) Afatgjatë;
  - d) a dhe b.

## II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA (G – gabim, S – saktë)

1. ----- PBB mund të rritet në dy mënyra, me rritjen e të mirave dhe shërbimeve dhe me stagnimin ose reduktimin e tyre, por me rritjen e çmimeve.
2. ----- PBB nominal prezanton nivelin real të rritjes ekonomike.
3. ----- Kurt ë ardhurat nga pagesat neto nga jashtë janë positive, Prodhimi Kombëtar Bruto është më i vogël nga PBB dhe anasjelltas.
4. ----- Deflatori tregon rritjen e nivelit mesatar të çmimeve (inflacionin) në një ekonomi kombëtare.

5. ----- PBB potencial tregon se ekonomia kombëtare punon me shfrytëzimin e plotë të resurseve disponuese dhe nivelet e plota të punësimit.
6. ----- Japonia është shteti i vetëm i cili në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013 ka pasur deflacion (rënie të nivelit mesatar të çmimeve).

### III. PËRGJIGJU PYETJEVE TË MËPOSHTME

1. Numëro 5 karakteristikat e PBB:

-----

-----

-----

-----

2. Trego 3 lloje të ardhurash të cilat burojnë nga huazimi i faktorëve të prodhimit:

-----

-----

-----

### IV. ZGJIDHI DETYRAT

1. Një fermer is het 30 ton grurë një fabrike buke me çmimin 500\$ për ton. Fabrika nga kjo sasi gruri prodhon 15 000 bukë, të cilat ajo is het nga 1.5\$. Cili është kontributi total i këtyre transaksioneve në PBB?

Zgjidhje:

Pasi që PBB shpreh vlerën e të gjithë të mirave dhe shërbimeve përfundimtare që realizohen në ekonominë e një vendi për një periudhë të caktuar kohore, kontributi total i këtyre transaksioneve në PBB do të jetë vetëm vlera e transaksionit të fundit.

Pra:

$$15\,000 \text{ bukë} \times 1.5\$ = 22\,500\$$$

Pjesë e PBB të këtyre transaksioneve do të jetë vlera 22 500\$

2. Një prodhues i gomave të makinës shet 100 000 goma një fabrike të veturave me çmim 50\$ për një gomë. Fabrika e veturave nga këto goma monton dhe shet 25 000 vetura, të cilat ajo i shet nga 7000\$. Cili është kontributi total i këtyre transaksioneve në PBB?
3. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme llogaritni PBB nominal, PBB real dhe deflatorin për çdo vit. Çmimet bazë janë ato të vitit 2012.

Viti	Të mirat dhe shërbimet	PBB nominal (QxP) Çmimet korente	PBB real Çmimi bazë i vitit 2012	Deflatori = PBB nominal/PBB real x100
	Ushqim	100 x 150 = 15 000	100 x 150 = 15 000	
	Armë	110 x 130 = 14 300	110 x 130 = 14 300	
	Shërbime	130 x 100 = 13 000	130 x 100 = 13 000	
<b>2012</b>	<b>Totali i PBB</b>	<b>42 300</b>	<b>42 300</b>	<b>100%</b>
	Ushqim	105 x 255 = 26 755	105 x 150 = 15 750	
	Armë	116 x 135 = 15 660	116 x 130 = 15 080	
	Shërbime	133 x 105 = 13 965	133 x 100 = 13 300	
<b>2013</b>	<b>Totali i PBB</b>	<b>56 400</b>	<b>44 130</b>	<b>127.80%</b>
	Ushqim	112 x 260 = 29 120	112 x 150 = 16 800	
	Armë	120 x 138 = 16 560	120 x 130 = 15 600	
	Shërbime	138 x 110 = 15 180	138 x 100 = 13 800	
<b>2014</b>	<b>Totali i PBB</b>	<b>60 860</b>	<b>46 200</b>	<b>131.73%</b>

### Zgjidhje:

**Sqarim:** Për të llogaritur PBB nominal shumëzohet sasia e të mirave dhe shërbimet me çmimet vijuese të viteve përkatëse.

Për të llogaritur PBB real shumëzohet sasi e të mirave dhe shërbimeve me çmimet e një viti bazë, që në rastin tone viti bazë është viti 2012, pra sasi e çmimet e vitit 2012.

$$\text{Deflatori (2012)} = \text{PBB nominal} / \text{PBB real} \times 100 = 42\,300 / 42\,300 \times 100 = 100\%$$

$$\text{Deflatori (2013)} = \text{PBB nominal} / \text{PBB real} \times 100 = 56\,400 / 44\,130 \times 100 = 127.80\%$$

$$\text{Deflatori (2014)} = \text{PBB nominal} / \text{PBB real} \times 100 = 60\,860 / 46\,200 \times 100 = 131.73\%$$

4. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme llogaritni PBB nominal, PBB real dhe deflatorin për çdo vit. Çmimet bazë janë ato të vitit 2008.
- 5.

Viti	Të mirat dhe shërbimet	PBB nominal (QxP) Çmimet korente	PBB real Çmimi bazë i vitit 2012	Deflatori = PBB nominal/PBB real x100
	Ushqim	80 x 100	80 x	
	Armë	95 x 110	95 x	
	Shërbime	120 x 115	120 x	
<b>2008</b>	<b>Totali i PBB</b>			
	Ushqim	110 x 120	110 x	
	Armë	130 x 140	130 x	
	Shërbime	135 x 125	135 x	
<b>2009</b>	<b>Totali i PBB</b>			
	Ushqim	125 x 280	125 x	
	Armë	140 x 150	140 x	
	Shërbime	145 x 130	145 x	
<b>2010</b>	<b>Totali i PBB</b>			

**V. PYETJE PËR PËRSËRITJE**

1. Ç'kuptoni me PBB? Përse ai llogaritet si treguesi më i rëndësishëm makroekonomik? Përse në PBB nuk llogaritet vlera e mallrave të ndërmjetme?
2. Cilët sektorë të ekonomisë paraqiten si konsumues të të mirave finale?
3. Ç'kuptoni me PBB nominal dhe potencial? Përse në analizat ekonomike për të vlerësuar standardin jetësor të popullsisë përdoret PBB real dhe jo ai nominal?
4. Përse në blerjet qeveritare, shpenzimet për pagesat e transfereve nuk përfshihen në PBB?
5. Përse PBB ka vlerë të njëjtë nëse matet me metodën e shpenzimeve ose atë të të ardhurave? Përsëritni metodat e matjes së PBB.
6. Ku ndryshon PBB nga GNP? Në cilat raste PBB është më i madh se GNP dhe në cilat ai është më i vogël? Ka mundësi ato mes veti të jenë të barabartë? Ilustro me një shembull të supozuar.
7. Ku është dallimi midis Prodhimit Kombëtar Bruto dhe Prodhimit Kombëtar Neto? Ç'kuptoni me amortizimin?

## **RRITJA EKONOMIKE**

### **I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA**

1. Norma e rritjes ekonomike tregon ndryshimin e:
  - a) PBB-së real dhe atij nominal;
  - b) PBB-së dhe PKB (GNP);
  - c) PBB të vitit të fundit krahasuar me atë paraprak të shprehur në %;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
2. Produktiviteti i punës në një ekonomi kombëtare njehsohet duke pjesëtuar PBB me:
  - a) Personat e papunë;
  - b) Numrin e popullsisë;
  - c) Numrin e punëtorëve;
  - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
  
3. Faktorët të cilët determinojnë produktivitetin e punës janë:
  - a) Kapitali fizik;
  - b) Kapitali human;
  - c) Resurset natyrore;
  - d) Të gjitha së bashku.
  
4. Sipas Malthusit, shtimi i popullsisë:
  - a) Nxit zhvillimin ekonomik;
  - b) Është neutral;
  - c) Frenon rritjen ekonomike;
  - d) Asnjërin nga të mësipërmet.

## II. ZGJIDHNI DETYRAT

1. Supozojmë se PBB real i një ekonomie kombëtare në vitin 2016 ka qenë 12 miliardë \$, në vitin paraprak ai ka qenë 10 miliardë \$. Sa është norma e rritjes ekonomike?

Zgjidhje:

Norma e rritjes ekonomike llogaritet:

$$G = \text{PBB (t)} - \text{PBB (t-1)} / \text{PBB (t-1)} \times 100$$

$$G = 12 \text{ miliardë \$} - 10 \text{ miliardë \$} / 10 \text{ miliardë \$} \times 100 = 20\%$$

Norma e rritjes ekonomike është 20%.

2. Supozojmë se PBB real i një ekonomie kombëtare në vitin 2018 ka qenë 16 miliardë \$, në vitin paraprak ai ka qenë 13 miliardë \$. Sa është norma e rritjes ekonomike?
3. Supozojmë se në çdo \$ të të ardhurave kombëtare, kapitali merr pjesë me 0.40\$ dhe puna me 0.60\$. Punësimi është rrit për 15%, kapitali për 10%, teknologjia ka avancuar për 6%. Të njehsohet norma e rritjes ekonomike.

**Zgjidhje:**

Norma e rritjes ekonomike nga faktorët e prodhimit njehsohet:

$$\Delta Y / Y = [(1 - \Theta) \times (\Delta N / N) + (\Theta \times \Delta K / K) + \Delta A / A]$$

$$\Delta Y / Y = (0.6 \times 15\%) + (0.4 \times 10\%) + 6\%$$

$$\Delta Y / Y = 9\% + 4\% + 6\% = 19\%$$

Norma e rritjes ekonomike është 19%.

4. Supozojmë se në çdo \$ të të ardhurave kombëtare, kapitali merr pjesë me 0.35\$ dhe puna me 0.65\$. Punësimi është rrit për 17%, kapitali për 9%, teknologjia ka avancuar për 8%. Të njehsohet norma e rritjes ekonomike.
5. Sa vite i nevojitet një vendi për të dyfishuar normë e rritjes së PBB, në qoftë se norma e rritjes mesatare të PBB është 2%?

**Zgjidhje:**

Kjo sqarohet me të ashtuquajturin rregulli 70, si vijon:

*Nëse numri 70 pjesëtohet me shkallën e rritjes ekonomike mesatare të shtetit, fi tohet periudha kohore, përkatësisht numri i viteve të cilat nevojiten për dyfi shimin e bruto prodhimit vendor të shtetit.*

*Pra  $70 / 2 = 35$ , që do të thotë se atij shteti do ti jenë të nevojshme 35 vite për të dyfishuar BPV-në aktuale.*

6. Sa vite i nevojitet një vendi për të dyfishuar normë e rritjes së PBB, në qoftë se norma e rritjes mesatare të PBB është 3.2%?

**III. PËRGJIGJU PYETJEVE TË MËPOSHTME**

1. Rivendos 4 faktorë të cilët ndikojnë në produktivitetin e punës:

-----

-----

-----

-----



2. Trego 4 faktorë të cilat politikbërësit mund t'i oërdorin për të nxit  
zhvillimin ekonomik:

---

---

---

---

#### **IV. PYETJE PËR PËRSËRITJE**

1. Përse ekonomistëve u intereson rritja ekonomike e periudhës afatgjatë? Përse disa shtete e arrin këtë objektivë e disa jo?
2. Përse shtetet jo mjaft të zhvilluara shënojnë norma më të larta zhvillimore nga shtetet e zhvilluara? Përse atëherë zhvillimi ekonomik dhe standardi jetësor i popullsisë së vendeve në zhvillim ngel shumë mbas shteteve të zhvilluara?
3. Ç'kuptoni me funksionin e prodhimit?
4. Përse ekonomitë e hapura rezultojnë me norma të larta zhvillimore dhe ato të mbyllura kanë ngecje ekonomike?
5. Ku është roli i politikave makroekonomike në rritjen ekonomike? Në cilët indikator mund të ndikojnë ato për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik?